REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 4468/2 prot. Gramsh më 31.11.2026

VENDIM

NR.82, Datë 30.10.2026

"Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë"

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë", bazuar në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social",neni 38,neni 73,pika 2, gërma v, VKM-së Nr.362,atë 29.05/.2019 "Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lire, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" VKM-së nr.459, date 03.07.2019 "Për rregullat për administrimit e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit ,mënyrën e financimit të subvencionit,monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" dhe ,të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015,"Për vetëqeverisjen vendore",neni 8;

V e n d o s i:

I. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Gramsh,si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar
1	Banesa me qira(Apartament 1+1)	muaj	1	10 000
2	Banesa me qira (Apartament 2+1)	muaj	1	11 000

3	Banesa me qira(Apartament 3+1	muaj	1	12 000

II. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qirate mesatare në tregun e lire sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt vendim.

III.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit...

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretare e Këshillit

Xhulia GJINI

Kryetare e Këshillit

Luljeta DOLLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH